

LEDIA DUSHKU

**ZBATIMI NË TERRENIN SHQIPTAR I PARITETIT
EKONOMIK HABSURGO-ITALIAN
(1912-1914)**

Hyrje

Marrëdhëniet austro-hungaro-italiane dallohen për një rrugëtim të gjatë në dukje linear, por në brendësi qartazi me ulje-ngritje të vazhdueshme. Stabiliteti i përkohshëm i këtyre marrëdhënieve u vendos atëherë kur të dyja palët pranuan kontrollin e njëra-tjetrës, në saje të bashkëpunimit me parime të qëndrueshme, ku dallon ai i paritetit. Artikulli synon t'i shpjegojë marrëdhëniet e Fuqive të Adriatikut me njëra-tjetrën dhe të këtyre të fundit me shtetin shqiptar, mbështetur në Teorinë Strukturore të Imperializmit, që mban emrin e profesorit të Universitetit të Oslos, Johan Galtung¹. Dy polet që formësojnë këtë teori janë *Qendra* dhe *Periferia*. Në rastin tonë, rolin e së parës e mbartin Austro-Hungaria e Italia, ndërsa atë të së dytit e luan shteti shqiptar, qendra e brendshme e së cilit është Qeveria e Përkohshme e Vlorës. Artikulli synon t'i japë përgjigje disa pyetjeve: Si mundën dy fuqitë rivale të shndërroheshin në fuqi aleate? Konkretisht në rastin e Shqipërisë, mbi bazën e cilave parime u ngrit marrëdhënia mes tyre? A pranuan Fuqitë e tjera të Mëdha të vepronin me të njëjtat parime sikurse Fuqitë e Adriatikut, për rastin shqiptar? Në fushën ekonomike, si operoi *Qendra* në raport me *Periferinë*?

Pariteti habshurgo-italian dhe Shqipëria

Krijimi në vitin 1866 i Bashkimit të Vogël Gjerman pa përfshirjen e Austrisë, shkëputja nga kjo e fundit e territoreve italiane në Lombardi dhe Veneto, si edhe hegjemonia e Rusisë në lindje të Evropës, konsiderohen

¹ Johan Galtung, "A Structural Theory of imperialism", <https://journals.sagepub.com/doi/10.1177/002234337100800201>, klikuar më 1 nëntor 2018.

faktorë të rëndësishëm që sollën përqendrimin në Gadishullin e Ballkanit të politikës së jashtme të Austro-Hungarisë, krijuar më 1867². Në vazhdim, synimi për të mos ia lënë Italisë përparësinë në rajon dhe kontradiktat me Rusinë për Çështjen Maqedonase, u shoqëruan me rishikimin e herëpashershëm të politikës së jashtme vjeneze ndaj Ballkanit, tashmë i vetmi rajon në të cilin Mbretëria Dualiste mund të matej me Fuqitë e tjera të Mëdha. Në një sistem të sofistikuar gjeostrategjik që përfshinte krejt Gadishullin, territoret e banuara nga shqiptarë u konsideruan një zonë ndikimi, ndoshta më të rëndësishmet për politikën habsburgase. Më pak se 60 milje larg bregdetit italian, ato luanin dy role kyçe: rolin parandalues ndaj Italisë mbi kontradiktat që dy kryeqytetet kishin për shkak të hegjemonisë në detin Adriatik; rolin e zonës tampon, në saje të të qenit territorialisht një mburojë kundrejt shtytjes sllave³. Vëmendja e prania e gjithëfarëshme në fushën fetare, arsimore, ekonomike, kulturore dhe sociale u bënë shtylla bazë të politikës së habsburgasve ndaj shqiptarëve, në procesin e stabilizimit të influencës së tyre në Shqipëri dhe Adriatik. Po ashtu, Monarkia synoi të realizojë një sprovë patronazhi mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, në të cilën ajo u rivalizua realisht nga Italia.

Kjo e fundit filloi të tregojë interes të dukshëm për çështjet ballkanike dhe konkretisht në atë shqiptare, dukshëm mbas disfatës në Adua të Abisinisë, më 1896, pikërisht atëherë kur Austro-Hungaria e kishte stabilizuar pozitën e saj. Në dallim nga Vjena, Roma i jepte Shqipërisë një rëndësi më specifike duke e vendosur thjesht në një rol antihabsburgas, në kërkim të fitimit të ndikimit mbi Adriatik⁴. Por,

² Për një trajtim të thelluar mbi politikën e jashtme ballkanike të Perandorisë Dualiste shih: Kurt Gostentschnigg, “Qëndrimet e Austro-Hungarisë ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në kontekstin e marrëdhënieve të përgjithshme austro-shqiptare”, në *Shqipëria-Austria: reflektim historiografik* (Aktet e Konferencave Shkencore Ndërkombëtare: Shkodër, maj 2012-Tiranë, tetor 2012) Tiranë: Botimet Albanologjike, 2013, f. 39-47; Kurt Gostentschnigg, Karl Kaser, “Albanologjia austro-hungareze 1867-1918 - një rast i imperializmit kulturor? Një projekt kërkimor”, *Hylli i Dritës*, Vjeti XXXIV, Nr. 1-2, Shkodër: 2014, f. 3-8; Kurt Gostentschnigg, *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär. Die österreichisch – ungarische Albanologie 1867-1918*, Springer VS: Wiesbaden, 2018, p. 263-377.

³ Edon Qesari, “Shqiptarët e përçarë: Përplasja italo-habsburgase për çështjen shqiptare mes fundshekullit XIX dhe fillimshekullit XX”, në *Shqipëria-Austria: reflektim historiografik...*, f. 98.

⁴ *I Documenti Diplomatici Italiani*, Terza Serie: 1896-1907, Volume II (1 maggio 1897-23 giugno 1898), Ministero degli Affari Esteri, Roma: Istituto Poligrafico dello Stato

dilema e thënies se, mes Italisë dhe Austro-Hungarisë ishin të mundura vetëm dy gjendje: aleanca ose lufta, nuk rezultoi e tillë për një kohë të gjatë. Me marrëveshjen verbale të Monzas të nëntorit 1897, pavarësisht dyshimeve dhe kundërshtive, dy kundërshtarët zgjodhën aleancën, si një përpjekje për të vendosur ekuilibrin mes tyre në Adriatik, duke ruajtur aty kontrollin reciprok. Marrëveshja e Monzës, e cila u konfirmua me notat e 20 dhjetorit 1900 dhe 9 shkurtit 1901, arriti kompromisin e madh historik mes interesave të Fuqive të Adriatikut në territoret e shqiptarëve, përmes ruajtjes së *status quo*-së. Nëse imponohej tjetërsimi i kësaj gjendjeje, palët do të bënin përpjekje që ndryshimet relative të zhvilloheshin në sensin e autonomisë, ndërkohë që angazhoheshin të kërkonin dhe të përdornin rrugë dhe mjete sa më të përshtatshme për pajtimin dhe ruajtjen e interesave reciproke⁵. Territoret e shqiptarëve mbeteshin kështu qoftë edhe vetëm *de jure*, nën varësinë e Sulltanit për sa kohë Perandoria Osmane do të ekzistonte. Deri në nëntor të 1912-ës, kjo shërbeu si bazë jo vetëm e marrëveshjeve bilaterale, por edhe e Aleancës së Trefishtë, ndonëse Italia konsiderohej nga Austro-Hungaria dhe Gjermania si aleati i pasigurtë, që mund të përkulej ndaj shteteve të Antantës.

Në këtë kuadër Shqipëria u trajtua si një çështje tërësisht dhe ekskluzivisht e ndarë në mënyrë paritare mes Perandorisë Dualiste dhe Italisë. Pariteti nga njëra anë dhe njohja e kompesimit adekuat të palëve në bregun lindor të Adriatikut nga ana tjetër, ishin dy parime të cilat ndikuan pozitivisht që të dy aleatët të anashkalonin çdo përplasje edhe pse me mundim. Mes një perandorie kokëfortë sa i përket këmbënguljes së të qenit gjithmonë në qendër të skenës (edhe pse dobësia e shekujve e tregonte hapur plakjen e saj), siç ishte ajo dualiste dhe, një fuqie të re vullnetmirë për t'u dukur sa më ambicioze ndërkombëtarisht, sikurse po e shpërfaqte veten Italia, pakti qëndroi⁶, të paktën deri në zhvillimet që ravijëzuan dy blloqet në kuadrin e Luftës së Parë Botërore. Si Roma

P.V, 1958, p. 191-194. Raport i A. Baldacci-t për ministrin italian të Punëve të Jashtme, Bolonja, 27 tetor 1897, p. 274-276; Raport i konsullit italian në Janinë, Millelire për ministrin e Punëve të Jashtme, Visconti Venosta, Janinë, 21 shkurt 1898.

⁵ *Po aty*, p. 215 (shënimi 2). Ambasadori italian në Berlin, Lanza për ministrin e Punëve të Jashtme, Visconti Venosta, Berlin, 27 nëntor 1897; Zef Prela "Problemi shqiptar dhe politika austro-hungareze (1897-1912)", në *Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare (përmbledhje studimesh kushtuar 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë)*, Tiranë: Mihal Duri, 1961, f. 112, 115; Gaetano Salvemini, *La politica estera dell'Italia dal 1871 al 1914*, Firenze: Barbera Edition, 1944, p. 114-115.

⁶ E. Qesari, "Shqiponja e përçarë: Përplasja italo-habsburgase...", f. 105.

ashtu edhe Vjena nuk lëvizën nga marrëveshja, pa marrë paraprakisht miratimin e njëra-tjetrës. Ato e kishin të qartë se çdo përparim reciprok në Shqipëri, do të realizohej vetëm pas një marrëveshjeje me terma paritarë mes tyre.

E tillë rezultoi situata edhe në vjeshtën e 1912-ës, kohë kur prishja e *statusquo*-së në Ballkan u bë realitet. Shpërthimi i Luftës së Parë Ballkanike dhe përparimi i ushtrive të Aleatëve veriorë Ballkanikë, mbartnin pasoja aq të rrezikshme për Mbretërinë Dualiste, sa mund të ndikonin edhe në ndryshimin e hartës së saj politike. Në të tillë situatë, krijimi i shtetit shqiptar autonom, ose të pavarur në rast zhdukjeje të plotë të sovranitetit osman, u konsiderua guri i themelit të politikës ballkanike të diplomacisë vjeneze⁷. Për këtë ajo luajti rolin e iniciatorit për një marrëveshje të re me Italinë dhe më tej, për arritjen e konsensusit brenda Tripalëshit.

Që prej fundit të nëntorit 1912, kur Austro-Hungaria mori pëlqimin e Italisë për të ecur me ose pranë saj në çështjen shqiptare⁸, pasi kishte garantuar mbështetjen pa kushte të Gjermanisë⁹, krijimi i shtetit shqiptar u bë pjesë e programit të rivlerësuar të Aleancës Tripalëshe. Synimi i ministrit habsburgas të Punëve të Jashtme, kontit Berchtold për ta trajtuar shtetin shqiptar dhe organizimin e tij si një kujdestari austro-hungaro-italiane, u bë boshti i konsultimeve intensive midis Vjenës e Romës. Pavarësisht divergjencave që dy aleatët kishin mes tyre, në tërësi bisedimet dhe më tej marrëveshjet dypalëshe u ngritën mbi parimin e pjesëmarrjes së barabartë. Sikurse edhe më herët, Shqipëria preferohej të trajtohej si një çështje prioritare në mos ekskluzive midis Austro-

⁷ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimi V (gusht-nëntor), përgatitja dhe redaktimi Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Fatmira Musaj, QSA, Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2012, f. 410-413. Protokollin e diskutimeve të zhvilluara në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vjenë, 25-30 tetor 1912.

⁸ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimi VI (nëntor-dhjetor), përgatitja dhe redaktimi Marenglen Verli, Ledia Dushku, QSA, Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2012, f. 221-222. Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Berchtold, për homologun e tij italian, San Giuliano (nëpërmjet ambasadorit austro-hungarez në Romë, von Mery), Budapest, 17 nëntor 1912.

⁹ *Arkivi i Institutit të Historisë-Tiranë* (më tej: *AIH*), A-VI-12/1, “Politika e kabineteve evropiane prej shtatorit 1913 deri korrik 1914 (marrë nga Akte diplomatike gjermane)”, fl. 212. Sekretari i Shtetit për Punët e Jashtme për ambasadorin gjerman në Vjenë, Berlin, 27 nëntor 1912.

Hungarisë dhe Italisë, si dy fuqitë që për shkak të pozitës gjeografike kishin interesa të drejtpërdrejta aty, duke synuar shmangien sa më shumë të ishte e mundur të ndërhyrjes nga fuqi të treta.

Marrëdhënia paritare habsburgo-italiane, me nxitjen dhe bekimin e Gjermanisë¹⁰, kulmoi me marrëveshjen e fshehtë dypalëshe, nënshkruar në Romë, më 8 maj 1913. Në kushtet e Krizës së Shkodrës, kur mbreti i Malit të Zi refuzonte të dorëzonte kështjellën e qytetit¹¹, duke përbërë rrezik për interesat e Austro-Hungarisë, palët rezervonin të drejtën të okuponin me iniciativën e tyre territorin e Shqipërisë, “*të cilin e ndajnë për këtë qëllim në dy pjesë të barabarta*”. Austro-Hungaria do të vendoste kontrollin e saj në krahinat sipër Shkumbinit, ndërsa Italia do të mbante gjithë pjesën jugore¹². Tërheqja e Malit të Zi, e konservoi aksionin e Fuqive të Adriatikut, duke e lënë marrëveshjen thjesht në letër dhe detyruar palët që në Shqipëri të ndiqnin politikën e “*penetration pacifique*”.

Konferenca e Ambasadorëve në Londër: anashkalimi i paritetit habsburgo-italian në organizimin e shtetit shqiptar

Politika paritare habsburgo-italiane në lidhje me organizimin e shtetit shqiptar u godit në thelbin e saj nga fryma dhe vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Që më 17 dhjetor 1912, në mbledhjen e parë të konferencës, çështja e statusit të Shqipërisë u prek jo vetëm në raport me Perandorinë Osmane, por edhe me Fuqitë e Mëdha.

¹⁰ *Archivio Storico e Diplomatico del Ministero degli Affari Esteri* (më tej: ASDMAE), Serie Politica P (1891-1916), Pacco 677, Albania, 1913. Telegram i ambasadorit italian në Berlin, Bollati për ministrin e Punëve të Jashtme, markezin di San Giuliano, Berlin, 4 maj 1913.

¹¹ Në lidhje me Krizën e Shkodrës dhe pasojat në planin diplomatik shih: Arben Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*, Tiranë: Toena, 2012, f. 184-202; Gazmend Rizaj, *Shqipëria e Sipërme, 1800-1913. Në projektet dhe traktatet e Fuqive të Mëdha dhe shteteve ballkanike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë: 2011, f. 402-416; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëllimi I, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2017, f. 124-142.

¹² *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik)*, përgatiti për botim Arben Puto, Vëllimi II (1912-1918), Tiranë: 8 Nëntori, 1987, f. 255-258. Marrëveshje e fshehtë midis Austro-Hungarisë dhe Italisë, nënshkruar në Romë, më 8 maj 1913; A. Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha ...*, f. 199-200.

Profesor Arben Puto evidenton se raportet e ambasadorëve janë unaninë kur thonë se ditën e parë të punimeve, Konferenca vendosi që Shqipëria autonome të vihej “*nën garancinë dhe kontrollin e Fuqive*” dhe të ishte “*neutrale*”¹³. Vendimi i 17 dhjetorit për t’i dhënë shtetit shqiptar një karakter ndërkombëtar të gjashtë të Mëdhenjve, duket se pësoi njëfarë devijimi me njohjen e rolit të veçantë, që për shkak të interesave të posaçme, konferenca i njohu Austro-Hungarisë dhe Italisë, duke i ngarkuar me hartimin e një projekti të detajuar “*mbi bazat e organizimit të ardhshëm të autonomisë*” së shtetit shqiptar.

Puna për projektin nxori në pah ndryshimin esencial që Fuqitë e Adriatikut kishin mes tyre, ndër të tjera, në çështjen e kontrollit ndërkombëtar mbi shtetin rishtar ballkanik. Italia, e frikësuar se një ortakëri e ngushtë habsburgo-italiane mund të kthehej në favor të Perandorisë Dualiste, pozitat e së cilës në faktorin e brendshëm shqiptar ishin të konsoliduara tashmë, i jepte kontrollit ndërkombëtar të Shqipërisë, pjesëmarrje të gjerë. Ambasadori në Vjenë, Avarna i nënvizonte kontit Berchtold se po t’i lihej trajtimi i çështjes shqiptare vetëm për vetëm dy Fuqive më të interesuara, atëherë do të shtohej rreziku i mosmarrëveshjeve midis tyre, kurse prania edhe e Fuqive të tjera mund të shërbente si një element pajtimi. Ministri vjenez i Punëve të Jashtme i qëndronte konsequent pikëpamjeve të mëhershme, duke e kundërshtuar me të madhe idenë e pjesëmarrjes së Të Gjashtëve në punët e Shqipërisë. Për të ishte pa vend, si në raport me të dy Fuqitë më të interesuara, ashtu edhe në raport me shtetin shqiptar, vendosja e Shqipërisë nën “*një kujdestari ndërkombëtar*”; përpunimi i të gjithë problemeve të shtetit shqiptar duhej të mbetej një ekskluzivitet i të dy Fuqive të Adriatikut, ndërsa Fuqitë e tjera mund të kishin disa kompetenca anësore. Me një pjesëmarrje më të gjerë, vijonte ai “*do të krijoheshin grupe të fuqive*”, “*administrata e shtetit të ri do të punonte shumë më ngadalë dhe do të ishte më e komplikuar*”. Kjo mund të bëhej shkak “*për mosmarrëveshje të thella*” midis Austro-Hungarisë dhe Italisë që kishin aty interesa më të drejtpërdrejta¹⁴.

Por, synimet e Berchtold-it për një “*sipërmarrje austro-hungaro-italiane*” në çështjen shqiptare ishin të destinuara të mbeteshin një dëshirë, përderisa nuk përputheshin me raportin real të forcave në frontin

¹³ A. Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha...*, f. 148.

¹⁴ *Po aty*, f. 235-238.

diplomatik. Kur as Italia nuk donte t'i bëhej ortakë e vetme, shihej qartë se pikëpamjet e tij nuk do të gjenin përkrahje në Konferencën e Ambasadorëve¹⁵. Tërheqja e parë erdhi javën e fundit të janarit, kur Austro-Hungaria pranoi idenë e kontrollit në nivel evropian me pjesëmarrjen e të gjashtë Fuqive për financat e shtetit shqiptar, ndërkohë që dy muaj më pas u njoh kontrolli i gjerë evropian edhe në administratën civile. Mbi këtë bazë, Fuqitë e Adriatikut arritën konsensusin mes tyre për pikat bazike të organizimit të shtetit shqiptar, projekt që iu paraqit konferencës më 8 maj 1913¹⁶, ditën kur dy aleatët nënshkruan në Romë marrëveshjen e fshehtë, të përmenduar më lart.

Në vijim, divergjencat mes Fuqive të Mëdha u lokalizuan në krijimin e mekanizmit, në saje të së cilit do të realizohej kontrolli ndërkombëtar i shtetit shqiptar. Konsensusi i vështirë u arrit në vendimin e 5 qershorit 1913, kur u vendos krijimi i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, ndërkohë që vijuan debatet mbi misionin dhe kohëzgjatjen tij. Përballja rezultoi e skajshme mes dy blloqeve: Tripalëshit dhe Antantës. Berchtold-i ishte i qartë dhe konsekuent kur shprehej se nuk e kuptonte zhvillimin e Shqipërisë “*në fazën e parë*” pa përkrahjen e Evropës dhe kontrollin e saj, por Vjena nuk mund të pranonte kurrësi një plan që do të përfundonte në ndarjen e influencës në Shqipëri në mënyrë të barabartë midis të gjashtë Fuqive të Mëdha. Nga ana tjetër, Antanta përkrahte po me aq ngulm një qëllim krejt të kundërt, vendosjen e një kontrolli ndërkombëtar sa më të gjerë, duke e ndarë influencën e Fuqive të Mëdha në mënyrë të barabartë për të gjashtë¹⁷. Gradualisht të dy palët filluan të tregonin shenja tërheqjeje nga pozicionet e ngurtësuar dhe u angazhuan në gjetjen e formulimeve të stërholluara diplomatike për të gjetur një zgjidhje të pranueshme¹⁸. Më 29 korrik 1913, Konferenca e Ambasadorëve miratoi vendimin përfundimtar për statusin dhe parimet mbi bazën e të cilave do të organizohej shteti shqiptar e do të hartohej statuti i tij.

¹⁵ *Po aty*, f. 238.

¹⁶ *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, 1912-1913*. Zgjedhje, përgatiti dhe redaktoi prof.dr. Muhamet Shatri, Tiranë: Toena, 2012, f. 535-537. Projekti austro-italian për organizimin e shtetit shqiptar, 8 maj 1913.

¹⁷ A. Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha...*, f. 270.

¹⁸ Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë, Vëllimi i parë (1912-1939)*, Tiranë: Toena, 2013, f. 112.

Mbështetur në të, qeverisja në Shqipëri, kryesisht administrimi civil dhe kontrolli i financave, do të kishte karakterin e një qeverisjeje kolektive nga të gjashtë Fuqitë e Mëdha. Kjo qeverisje do të realizohej nëpërmjet Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, “*të përbërë nga delegatët e të gjashtë Fuqive dhe nga një delegat i Shqipërisë*” (neni 4)¹⁹. Ky institucion ndërkombëtar në bashkëpunim me pushtetin që i jepej Princit, si kryetar i shtetit dhe njëkohësisht mëshirues i pushtetit ekzekutiv, përbente autoritetin e lartë të vendimmarrjes në Shqipëri. Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit kishte tiparet e një organizmi shtetformues, mbikëqyrës, kujdestar dhe kontrollues. Kompetencat e tij do të zgjatnin 10 vjet dhe mund të përtëriheshin në rast nevojë (neni 5). Krahas projektit të organizimit të hollësishëm të të gjitha degëve të administratës së Shqipërisë (neni 6), sipas profesor Romeo Gurakuqi pjesë e qenësishme e misionit të tij ishte edhe plotësimi i tranzicionit të këtij entiteti, nga sundimi osman në pavarësi²⁰.

Më 29 korrik 1913, Konferenca e Ambasadorëve në Londër vendosi kështu konstituimin e shtetit shqiptar, si një ndërmarrje ndërkombëtare që i përkiste të gjashtë Fuqive të Mëdha. Ndonëse nuk u shpreh hapur pjesëmarrja dhe përgjegjësia paritare e Të Gjashtëve, ishte qartazi e kuptueshme se organizimi i shtetit shqiptar nën kujdestarinë/mbikëqyrjen paritare habshurgo-italiane, me këtë vendim ishte anashkaluar.

Nga tryezat diplomatike në terrenin shqiptar: Pariteti austro-hungaro-italian në projektet ekonomike në Shqipëri

Pavarësisht frymës dhe vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, Austro-Hungaria dhe Italia vepruan të zbatonin politikën e tyre paritare, sidomos në fushën ekonomike. Menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Fshehtë të 8 majit 1913, zyrtarët e lartë austro-hungarezë përgatitën dokumentin e njohur si “Aksioni në Shqipëri”. Duke synuar “gozhdimin” përfundimtar të Italisë dhe evitimin e konflikteve eventuale me të, “Aksioni” parashtronte masa me karakter paritar në bashkëpunimin dypalësh. Theksi vihej tek masat

¹⁹ *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, 1912-1913...*, f. 606-607. Vendimi i Konferencës së Londrës për organizimin e shtetit shqiptar, 29 korrik 1913; A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...*, Vëll. II (1912-1918), f. 278-280.

²⁰ Romeo Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914*, Tiranë: UET Press, 2012, f. 529, 593.

që përvijonin “*penetration pacifique*” si: dërgimi i nëpunësve austro-hungarezë e italianë në institucione të ndryshme të administratës qendrore shtetërore shqiptare; evitimi i mundshëm i emërimit të shqiptarëve në vendet më të rëndësishme të saj; themelimi i një konsorciumi financiar me kontribute financiare e njerëzore të barabarta, që do të kishte në ngarkim financimin e të gjitha ndërmarrjeve në Shqipëri, konkretisht themelimin e bankave, ndërtimin e rrugëve, të hekurudhave etj.²¹

Mbi bazën e këtij dokumenti, në *Ballhausplatz** u punua për përgatitjen e një marrëveshjeje ekonomike dypalëshe, të fshehtë, në saje të së cilës, sipërmarrjeve austro-hungareze dhe italiane do t’u sigurohej një epërsi ekonomike në Shqipëri²². Pas diskutimeve palët duket se rakorduan qëndrimet dhe, më 12 korrik 1913, ministri italian i Punëve të Jashtme, markezi di San Giuliano i përcolli vartësve të tij në Shkodër, Durrës dhe Vlorë, informacionin konfidencial mbi gatishmërinë e qeverisë së Austro-Hungarisë për një marrëveshje të përbashkët ekonomike, shoqëruar me tekstin për mendim.

Sipas markezit di San Giuliano, kjo marrëveshje, e cila do të ishte në fuqi deri sa të mbahej regjimi i kapitulacioneve në Shqipëri:

“... do të sigurojë për të dyja palët në paritet të plotë të gjitha sipërmarrjet, për të cilat është e nevojshme dhënia e privilegjeve të veçanta nga ana e qeverisë qendrore të Shqipërisë që kanë të bëjnë me koncensionet në fushat me rëndësi vitale si hekurudha, porte, rrugë, ndërtesa publike, komunikacion, banka të privilegjuara, shfrytëzimin minierash, shfrytëzimin pyjesh etj. [...]”²³.

²¹ *Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: HHSt.A.PA.A), në *AIH*, Vj. 23-20-2013, Aksioni në Shqipëri, 15 maj 1913.

* Kështu quhej Ministria e Punëve të Jashtme e Austro-Hungarisë.

²² *HHSt.A.PA.A*, në *AIH*, Vj. 24-41-4119. Propozimi austro-hungarez për marrëveshjen e përbashkët ekonomike me Italianë.

²³ Konkretisht sipas draft marrëveshjes:

“Austro-Hungaria dhe Italia angazhohen të respektojnë parimin e pjesëmarrjes dhe influencës së barabartë në të gjitha sipërmarrjet ekonomike në Shqipëri, të cilat varen nga ndonjë koncesion, privilegj apo ndonjë favor i dhënë nga qeveria shqiptare apo autoritetet e tjera publike të vendit, që për nga rëndësia e tyre do u japë sipërmarrësve një përparësi të madhe ekonomike në vend. Në lidhje me sipërmarrjet tregtare, industriale dhe bujqësore të ndryshme nga sa u përmendën më sipër, nuk do të ketë asnjë pengesë për të drejtat e veprimt të nënshtetasve të të dyja Fuqive.

Në vijim, duke anashkaluar vendimmarrjen e Koncertit Evropian, puna u përqendrua në ndarjen e sektorëve të ekonomisë shqiptare, ku do të dërgoheshin specialistë prej secilit shtet. Propozimi erdhi nga qeveria italiane, e cila më 26 korrik i kërkoi Vjenës “*arritjen e një marrëveshjeje mbi emërimin e funksionarëve austro-hungarezë dhe italianë si nëpunës shteti në Shqipëri. Me këtë rast ... të veprohet në bazë të paritetit të plotë*”²⁴. Më 1 gusht 1913, ministri i Punëve të Jashtme, konti Berchtold i kërkoi ambasadorit në Romë, von Mery që t’i përqendronte përpjekjet e tij në arritjen “*sa më parë të një marrëveshjeje me San Giuliano-n mbi çështjen e specialistëve që do të dërgohen [në Shqipëri]*”²⁵.

Pas një varg bisedimesh me kundërshti jo të pakta, më 13 tetor 1913, Vjena dhe Roma u dakordësuan që të zbatohet me rreptësi principi i pjesëmarrjes dhe ndikimit të barabartë në ndërmarrjet e rendit ekonomik në Shqipëri; specialistë austro-hungarezë të dërgoheshin në sektorin e postës, doganave, pyjeve, blegtorisë, organizimin e komunave fshatare dhe kontabilitetin publik, ndërsa italianë në sektorin e telegrafës, doganave, pyjeve, agrikulturës, drejtësisë, porteve dhe minierave²⁶.

Sipërmarrjet për të cilat duhet të respektohet parimi i pjesëmarrjes në raport të barabartë nga të dyja shtetet kanë të bëjnë veçanërisht me: punimet dhe shërbimet publike në lidhje me hekurudhat, portet, rrugët, kanalizimet, koncensionet e transportit, bankat, shfrytëzimi pyjor dhe minerar, si dhe ndërtimi i infrastrukturës publike, furnizime për shtetin, departamentet, komunat dhe kreditë. Ndarja në pjesë të barabarta do të respektohet si përsa i përket personelit të huaj ashtu edhe për materialet e porositura nga jashtë [...]”. ASDMAE në AIH, Politica P (1891-1916), Pacco 155, Turchia, posic. 17. Njoftim i ministrit të Punëve të Jashtme të Italisë për konsujt në Shkodër, Durrës dhe Vlorë. Përcjell draft marrëveshjen mbi veprimet ekonomike italo-austriake në Shqipëri, Romë, 12 korrik 1913.

²⁴ HHS.A.P.A.A në AIH, Vj.23-28-2861. Telegram i kontit Berchtold për ambasadorin, von Mery në Romë, Vjenë, 26 korrik 1913. Transmeton njoftimin e ambasadorit italian në Vjenë.

²⁵ Po aty, Vj.23-28-2864. Telegram i kontit Berchtold për ambasadorin von Mery në Romë, Vjenë, 1 gusht 1913.

²⁶ Po aty, Vj. 23-28-2893. Telegram i kontit Berchtold për kontin Ambrosy në Romë dhe konsullin Lejhanec në Vlorë, Vjenë, 13 tetor 1913; po aty, Vj. 23-29-2918. Ekstrakt i raportit nga ambasada austro-hungareze në Romë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 22 tetor 1913.

Projekti i dërgimit të nëpunësve austro-hungarezë e italianë në Shqipëri dhe Qeveria e Përkohshme e Vlorës

Që prej 4 dhjetorit të vitit 1912, në terrenin shqiptar vepronte Qeveria e Përkohshme e Vlorës, e krijuar prej Kuvendit Kombëtar si shprehje e vullnetit të shqiptarëve, por me status të panjohur nga Fuqitë e Mëdha. Përvijimi i linjave kryesore të politikës ekonomike të kësaj qeverie u bë nën ndikimin dhe trysinë e “*dy fuqive protektore*”, sikurse cilësoheshin Austro-Hungaria dhe Italia prej kryetarit, Ismail Qemal Vlora²⁷.

Në fund të korrikut 1913, atëherë kur Konferenca e Ambasadorëve në Londër merrte vendimet përfundimtare për Shqipërinë dhe Fuqitë e Adriatikut bënë përpjekje për njohjen e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, si autoritet kombëtar, Ismail Qemali iu lut verbalisht konsujve austro-hungarezë dhe italianë, që t’u sugjeronin qeverive të tyre dërgimin e këshilltarëve dhe specialistëve për organizimin e degëve të ndryshme të ekonomisë shqiptare. Specialistët e huaj nën orientimin e organeve qeveritare shqiptare, do të kishin për detyrë të studionin vendin dhe t’i paraqitnin propozime konkrete qeverisë për projektet më urgjente që duheshin ndërmarrë²⁸. Më 7 gusht 1913, konsujt respektivë i kërkuan kryetarit të Qeverisë së Përkohshme listën konkrete të këshilltarëve të huaj të dëshiruar nga pala shqiptare²⁹. Kjo kërkesë *de facto* i jepte qeverisë së Ismail Qemalit statusin e partnerit shqiptar të Fuqive të Adriatikut.

Lutja verbale e Ismail Qemal Vlorës, iu përcoll e detajuar dhe plotësuar me informacion konfidencial, kontit Berchtold nga konsulli

²⁷ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913)*, përgatiti për botim Valentina Duka, Tiranë: Toena, 2012, f. 353. Konsulli i përgjithshëm Lamb për sekretarin britanik të Punëve të Jashtme, E. Grey, Vlorë, 5 nëntor 1913.

²⁸ *HHSSt.A.P.A.A*, në *AIH*, Vj. 23-28-2865. Telegram i konsullit austro-hungarez në Vlorë, Lejhanec për ministrin e Punëve të Jashtme, kontin Berchtold, Vlorë, 31 korrik 1913; Kaliopi Naska, “Politika ekonomike e Qeverisë së Vlorës (nëntor 1912-janar 1914)”, në *Studime Historike*, nr. 1/1988, Tiranë: 1988, f. 89.

²⁹ *HHSSt.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 23-28-2867. Telegram nga Ministria e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për ambasadorin në Romë, Vjenë, 6 gusht 1913; *po aty*, Vj. 23-28-2863. Telegram nga ministri i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për ambasadorin, Mery në Romë, Vjenë, 7 gusht 1913; *po aty*, Vj. 23-28-2862. Telegram i konsullit austro-hungarez në Vlorë, Lejhanec për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Vlorë, 7 gusht 1913.

Lejhanec, më 14 gusht 1913. Qeveria e Përkohshme kërkonte 16 specialistë në fusha të ndryshme të ekonomisë shqiptare, ndarja e të cilave do të duhej të bëhej prej dy fuqive mbrojtëse sipas një marrëveshjeje të lirë. Konsulli bënte me dije edhe preferencat e Ismail Qemal Vlorës për këtë ndarje. Prej Austro-Hungarisë ai parapëlqente “... organizatorë për postën, rrugët, hekurudhat, postat, bujqësinë dhe pyjet, ndërsa prej Italisë organizatorë për telegrafët, instalimet vaditëse dhe mundësisht për minierat dhe drejtësinë. Mbi degët e tjera Ismail Qemali nuk është shprehur”³⁰. Specialistët duhej të ishin të zotë, me eksperiencë dhe autoritetin e duhur nga rangjet e mesme. Paga maksimale vjetore e ofruar shkonte nga 6.000 deri në 8.000 franga³¹. Kryetari Vlora preferonte që kontratat të ishin me afat të paracaktuar 1-vjeçar, me përjashtim të specialistëve për punët botore dhe bujqësinë, kontratat e të cilëve do të duhej të ishin 3-vjeçare.

Në vijim, diplomacitë në Vjenë e Romë u angazhuan intensivisht në përpilimin e një note, të cilën Ismail Qemal Vlora do të duhej t’ia përcillte në mënyrë integrale, në emër të qeverisë së tij, konsujve austro-hungarezë dhe italianë në Vlorë. Teksti i përpiluar në Vjenë, në dhjetëditëshin e parë të tetorit 1913³², mbështetej në informacionin e dërguar më 14 gusht nga konsulli Lejhanec. Hartuesit ishin kujdesur për të evidentuar qartë përkrahjen habsburgo-italiane ndaj Shqipërisë, si dhe dëshirën e Qeverisë së Përkohshme për të punësuar 16 specialistë austro-hungarezë dhe italianë, si këshilltarë dhe organizatorë në fusha të ndryshme të ekonomisë shqiptare. Krahas pagës, qeveria e Vlorës do të duhej të merrte përsipër pagesën e shpenzimeve të udhëtimeve dhe dietat e ekspertëve për shërbimet brenda vendit. Në dallim nga lutja verbale e gushtit, në notën e përgatitur në Vjenë, paga kishte pësuar rritje. Ajo ishte fiksuar në 8.000 franga në vit, madje për raste të veçanta parashikohej të shkonte deri në 12.000 franga, duke rënduar financat e brishta të shtetit

³⁰ *Po aty*, Vj. 23-28-2870. Raport i konsullit Lejhanec nga Vlora për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, Vlorë, 14 gusht 1913.

³¹ Për shkak të financave të dobëta, paga me të cilën Qeveria e Përkohshme e Vlorës merrte përsipër që të paguante specialistët e huaj, ishte 3 herë më e vogël se paga që merrte anëtari i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Shih: *Po aty*, Vj. 24-11-1118.

³² *Po aty*, Vj. 23-28-2886. Njoftim i ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë dërguar kontit Ambrozy në Romë, Vjenë, 26 shtator 1913; *po aty*, Vj. 23-28-2897. Njoftim i ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë dërguar konsullit Lejhanec në Vlorë, Vjenë, 15 tetor 1913.

shqiptar. Nota përmbante angazhime shtesë në emër të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, sa i përket kontratave, për më tepër kjo e fundit do të duhej të mos ndikonte në përzgjedhjen e nëpunësve. Ajo do të duhej të merrte përsipër angazhimin se do të emëronte personat që qeveritë respektive austro-hungareze dhe italiane i shihnin të udhës³³. Nota tregonte qartë imponimin që dy Fuqitë e Adriatikut kërkonin nga qeveria e Vlorës. Për ta vënë para faktit të kryer Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, nota do të duhej të mbante datën 9 shtator, pra para se anëtarët e tij të mbërrinin në Shqipëri³⁴.

Ndërkohë një notë e dytë po përgatitej sakaq në ambientet diplomatike të Fuqive të Adriatikut. Ajo do të ishte përgjigja që konsujt austro-hungarezë e italianë do t'i kthenin notës së përgatitur për Ismail Qemal Vlorën³⁵. Ecuria nga përpilimi i notave *mutandis-mutandis* deri tek firmosja dhe shkëmbimi i tyre në Vlorë, konsiderohej prej diplomatëve vjenezë si “procesi i shkëmbimit të notave”.

Por ky ishte vetëm një aspekt i çështjes. Që prej fundit të shtatorit 1913, vetë konti Berchtold ishte angazhuar për përgatitjen e kontratave, të cilat pasi të merrnin miratimin e qeverisë italiane, mund të përdroreshin si kontrata përfundimtare mes qeverisë shqiptare dhe funksionarëve austro-hungarezë dhe italianë³⁶. Një e tillë ishte kontrata e përgatitur që fiksonte

³³ *Po aty*, Vj. 24-33-3361. Teksti i notës që Ismail Qemali, kryetar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, do të duhej t'i dërgonte konsullit austro-hungarez dhe atij italian në Vlorë për dërgimin e ekspertëve nga qeveritë përkatëse pranë qeverisë shqiptare.

³⁴ *Po aty*, Vj. 23-28-2898. Telegram i kontit Ambrozy nga Roma për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 14 tetor 1913.

³⁵ Teksti i notës përgjigje të konsullit austro-hungarez ndaj kryetarit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës do të ishte si më poshtë:

“Në përgjigje të notës suaj të kam nderin t’ju bëj të njohur se qeveria ime është gati të japë përkrahjen e saj për organizimin administrativ të Shqipërisë duke vënë në dispozicion të saj këshilltarët-organizatorë që kërkohen. Meqenëse e njëjta kërkesë i është drejtuar edhe qeverisë mbretërore italiane, qeveria ime perandorake e mbretërore e Austro-Hungarisë u mor vesh me qeverinë mbretërore të Italisë, përta i përket ndarjes së vendeve të organizatorëve. Nga kjo marrëveshje del se Austro-Hungaria do të marrë përsipër të dërgojë organizatorë për postat, doganat, pyjet, rritjen e bagëtive, komunitat fshatare, rrugët dhe kontabilitetin publik. Në pritje të udhëzimeve të detajuara që nuk do të vonojnë të vijnë, dëshiroj të shtoj se qeveria ime ka marrë në shënim angazhimin e qeverisë së përkohshme shqiptare që të marrë në shërbim funksionarët që unë do të kem nderin të propozoj”. *HHSSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 24-33-3361.

³⁶ *Po aty*, Vj.23-28-1884. Telegram i kontit Berchtold për kontin Ambrozy në Romë, Vjenë, 26 shtator 1913.

angazhimin e organizatorit të pyjeve, e cila do të shërbente si model edhe për specialistët e fushave të tjera³⁷. Fuqitë e Adriatikut ranë dakord që kontrata të përpilohej në dy kopje me të njëjtin tekst, të nënshkruhej prej kryetarit të Qeverisë Provizore shqiptare dhe funksionarit përkatës, në prezencën e konsullit austro-hungarez ose atij italian në Vlorë. Ajo do të mbante si datë 9 tetorin, kur ishte arritur marrëveshja gojore midis të Ngarkuarit me Punë të Austro-Hungarisë në Romë dhe sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, mbi procedurën që duhej ndjekur me qeverinë shqiptare për angazhimin e organizatorëve³⁸. Ndonëse, ministri i Jashtëm austro-hungarez

³⁷ Modeli i kontratës së përgatitur ishte:

“Kontratë shërbimi lidhur midis Qeverisë Provizore shqiptare në njërën anë dhe z. N.N në anën tjetër.

1. Z. N.N me pëlqimin e Ministrisë së Agrokulturës austriake në Vjenë merr postin e një specialisti drejtues në Ministrinë e Ekonomisë së Shqipërisë, që ofron Qeveria Provizore Shqiptare, për të organizuar në Shqipëri administratën pyjore. Puna ka të bëjë sidomos me përpunimin e projektligjeve dhe dispozitave të eksportit që asaj i nevojiten, si dhe me rregullimin e drejtimin e shërbimit pyjor;

2. Posti është drejtues dhe në çështjet profesionale autonom. Selia e zyrës është (në kryeqytetin e ardhshëm të Shqipërisë);

3. Kontrata zgjat 1 vit, por me dëshirën e qeverisë shqiptare dhe në marrëveshje me palën kontraktuese, kontrata mund të zgjatet.

4. Z. N.N. çdo vit i jepet një leje dy mujore, prej 1 korrikut deri 31 gusht. Z. N.N. do ta fillojë detyrën vonë, vonë më ...;

5. Si rrogë vjetore caktohen ... franga të pagueshme në 12 rata të njëpasnjëshme, më 1 të çdo muaji, pa asnjë zbritje për tatime dhe taksa të tjera. Për kohën nga dita e paraqitjes së z. N.N. për fillimin e detyrës në kryeqytetin e Shqipërisë deri më 1 të muajit tjetër atij i takon paga *pro rata temporis*. Gjatë udhëtimeve me shërbim, i përmenduri përveç shpenzimeve të udhëtimit d.m.th. për trenin, respektivisht karrocën, kalin e shalën dhe për transportin e bagazhit i takojnë dieta ... franga në ditë. Si dëmshpërblim për udhëtimin vajtje - ardhje nga kryeqyteti i Shqipërisë për në destinacion do të paguhet një shumë prej ... franga.

Lidhur në [Vlorë], më, ...[data]

Në emër të Qeverisë Provizore të Shqipërisë: Ismail Qemal m.p.

N.N (nënshkrimi i nëpunësit)

E redaktuar në prezencën e konsullit perandorak e mbretëror në [Vlorë], më, ...[data]

Nënshkrimi i konsullit dhe vula e zyrës së tij.

Shih: *HHS.A.P.A.A në AIH*, Vj. 23-28-1886. Njoftim i kontit Berchtold për kontin Ambrozy në Romë, Vjenë, 26 shtator 1913.

³⁸ *Po aty*, Vj. Vj. 23-29-2916. Ekstrakt raporti nga ambasada austro-hungareze në Romë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 11 tetor 1913.

parapëlqente që dokumentit t'i vendosej një datë edhe më e hershme, në mënyrë që të mos ishte tepër afër me fillimin e punës së Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit*, ai shprehte bindjen se përcaktimi i saj “në asnjë mënyrë nuk duhet të vonojë kryerjen e shkëmbimit të notave, që duhet të datojë patjetër para fillimit nga puna të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit”³⁹.

Pasi dy kancelaritë u dakordësuan mes tyre, më 13 tetor 1913 konsulli austro-hungarez në Vlorë mori nga eprori i tij i lartë, konti Berchtold njoftimin që vijon:

“Duke marrë parasysh konstituimin e shpejtë të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit është nevoja t'i jepni siguri Ismail Qemalit përsa i përket dërgimit të këshilltarëve specialistë sipas raportit tuaj, të datës 14 gusht 1913, në mënyrë që qeveria shqiptare të mos u drejtohet fuqive të tjera me anë të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit [...] Është me rëndësi që ju të fitoni bindje se Ismail Qemali e konsideron veten të lidhur prej deklaratave të dhëna gojazi më herët mbi këtë dhe nuk do ta përdorë veprimtarinë e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, për t'u okupuar nga një palë e tretë, për postet e këshilltarëve specialistë që na i ofroi neve dhe Italisë”⁴⁰.

Dy ditë më pas informacioni që u përcoll nga *Ballhausplatz*-i për në Vlorë ishte plotësuar⁴¹. Dërgohej teksti i notës zyrtare që Ismail Qemali do të duhej t'i përcillte konsujve respektivë, notë përgjigjja që konsujt do të duhej të shkëmbenin me të, si edhe modeli i kontratës së shërbimit. Ministri i Punëve të Jashtme shpjegonte edhe arsyen pse nuk ishte plotësuar kërkesa e Ismail Qemal Vlorës për dërgimin e një specialisti në sektorin e hekurudhave. Organizimi i këtij sektori konsiderohej i parakohshëm në kushtet kur “*Shqipëria para së gjithash ka nevojë për një konsolidim ekonomik e financiar. Para se të mendohet për krijimin e bazave të organizimit të hekurudhave, së pari ajo duhet të ketë arritur një gradë zhvillimi në të dy degët e tjera të komunikacionit (lundrim dhe*

* Mbledhja e parë e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit u zhvillua, më 16 tetor 1913 në Vlorë.

³⁹ *Po aty*, Vj. 23-28-2897. Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për konsullin Lejhanec në Vlorë, Vjenë, 15 tetor 1913.

⁴⁰ *Po aty*, Vj. 23-28-2893. Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për konsullin Lejhanec në Vlorë, Vjenë, 13 tetor 1913.

⁴¹ *Po aty*, Vj. 23-28-2897. Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë dërguar konsullit Lejhanec në Vlorë, Vjenë, 15 tetor 1913.

rrugë)”. Konsulli porositej që “*këto fjalë t’ia thoni Ismail Qemal beut vetëm me gojë dhe në bisedim e sipër, derisa ato nuk i përmbajnë notat që do të shkëmbehen*”⁴². Njëkohësisht informacioni përcillte urdhrin se angazhimi parimor i qeverisë provizore shqiptare kundrejt specialistëve austro-hungarezë e italianë duhej të fiksohej sa më shpejt me shkrim, me patjetër para se të fillonte veprimtarinë Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Instruksione të ngjashme kishte marrë edhe konsulli italian në Vlorë⁴³.

Por, pavarësisht instruksioneve, shkëmbimi i notave me Qeverinë e Përkohshme të Vlorës nuk u krye dhe projekti për dërgimin e nëpunësve austro-hungarezë e italianë nuk u zbatua. Si shkak për këtë, dokumentacioni austro-hungarez i konsultuar deri më tani, evidenton “*heqjen dorë të Ismail Qemalit*”, pa parashtruar arsyet e këtij veprimi⁴⁴.

Në një përpjekje për të zbuluar arsyet, na vjen në ndihmë biseda e kryetarit të Qeverisë së Përkohshme me konsullin italian në Vlorë. Prej saj zbulon pakënaqësinë e Ismail Qemalit në lidhje me statusin e “*vëzhgueses pasive*” që “*shtetet protektore*” po i jepnin qeverisë së tij. Ai shprehte bindjen se Qeveria e Përkohshme “*duhet të ruajë edhe një farë iniciative, me qëllim që veprimtaria ekonomike në Shqipëri të mos paralizohet, qoftë prej plogështisë së dy shteteve protektorë, qoftë dhe prej mosmarrëveshjes së tyre eventuale në disa çështje të caktuara*”⁴⁵. Vihet re kështu një përpjekje e Ismail Qemal Vlorës për të shmangur varësinë e plotë ekonomike të qeverisë së tij ndaj Fuqive të Adriatikut, me synimin për ta mbajtur Shqipërinë mundësisht jashtë rivalitetit të dy aleatëve.

Por, kjo ishte vetëm njëra anë e medaljes. Frika e stimuluar në mënyrë të pavarur tek Austro-Hungaria dhe Italia, se njëra mund të fitonte në kurriz të tjetrës, në kushtet e përshtypjes së krijuar se kryetari i Qeverisë së Përkohshme mbështeste në mënyrë alternative planet e dy

⁴² *Po aty*, Vj. 23-28-2897. Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë dërguar konsullit Lejhanec në Vlorë, Vjenë, 15 tetor 1913.

⁴³ *Po aty*, Vj. 23-28-2898. Telegram i kontit Ambrozy nga Roma për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 14 tetor 1913. Transmeton njoftimin se konsulli italian në Vlorë ka marrë telegrafisht instruksionet e dëshiruara mbi projektin e shkëmbimit të notave.

⁴⁴ *Po aty*, Vj. 24-33-3348. Relacion i përgatitur për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë nga specialisti, Jovanoviç, Vjenë, 10 prill 1914.

⁴⁵ *Po aty*, Vj. 23-15-1586. Relacion i konsullit austro-hungarez në Vlorë për ministrin e Punëve të Jashtme, kontin Berchtold, Vlorë, 13 gusht 1913.

aleatëve, formësuan perceptimin e “braktisjes” së Ismail Qemal Vlorës prej “fuqive protektore”. Ndërkaq, në vjeshtë të 1913-ës vihet re dominimi i skenës politike shqiptare nga krahu politik kundërshtar i Ismail Qemalit, personifikuar me emrin e Esat Pashë Toptanit. Mbështetja e artikuluar në opinionin politik dhe publik që këtij të fundit po i jepej tashmë nga Italia dhe/ose Austro-Hungaria, të bëjnë të mendosh se edhe tek vetë Fuqitë e Adriatikut ekzistonte një frymë mosbesimi ndaj qeverisë së Ismail Qemal Vlorës.

Në kuadër të kësaj analize, me fillimin e punës së Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, kryetari Vlora i shprehu qartë delegatëve francezë, britanikë dhe rusë, nevojën e mbështetjes në përpjekjet e tij për të ndaluar që “*shteti i porsalindur të bëhej viktimë e ‘monopolit’ nga ana e cilësdo Fuqi të veçantë, apo Fuqive të veçanta*”. Për delegatin britanik, njëkohësisht konsull i Përgjithshëm, Harry Lamb, ky qëndrim i kryetarit të qeverisë së Vlorës, pa dyshimin më të vogël lidhej me faktin se “*ai në këtë moment ndihet tepër i shkurajuar dhe i turpëruar nga mënyra me të cilën ‘protektorët’ e tij, siç i quan ai vetë ata, janë duke e trajtuar atë*”. Në një situatë të tillë, vijon Lamb, kryetari të Qeverisë së Përkohshme “*i jep një kënaqësi dhe lehtësim të konsiderueshëm që të mendojë se në të ardhmen mund të gjejë mbështetje në një rreth, të cilin ai deri tani ishte i detyruar që, si pasojë e rrethanave, ta konsideronte si kundërshtar ndaj tij dhe ndaj pretendimeve të tij*”⁴⁶.

Pas dorëheqjes së Ismail Qemal Vlorës dhe qeverisë së tij, në janar 1914, çështja e dërgimit të specialistëve dhe këshilltarëve të huaj në administratën shqiptare u hap sërish. Menjëherë pas mbërritjes në Shqipëri të Princit Wilhelm von Wied, qeveria e sapoformuar shqiptare iu drejtua të dërguarve diplomatikë austro-hungarezë dhe italianë në Durrës, me një lutje me shkrim. Në dallim nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës, ajo me kryeministër Turhan Pashë Përmetin u kërkoi homologëve në Vjenë dhe Romë jo 16, por vetëm 4 specialistë në secilën nga fushat: miniera, bujqësi, postë-telegraf dhe punë botore. Austro-Hungarisë dhe Italisë iu la në dorë edhe zgjedhja e një këshilltari për financat, duke preferuar si të tillë një me kombësi belge, si edhe ajo e një organizatori për shërbimin e porteve, duke i dhënë preferencë një ish oficeri marine⁴⁷.

⁴⁶ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët...*, Vëll. I, përg. V. Duka, f. f. 353. Konsulli i përgjithshëm Lamb për E. Grey-n Vlorë, 5 nëntor 1913.

⁴⁷ *HHSt.A.P.A.A në AIH*, Vj. 24-33-3318. Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për kryeministrin e Austrisë dhe atë të Hungarisë, Vjenë, 3 prill

Kërkesa e qeverisë shqiptare rihapi letrat e vjetra dhe nxori në pah vështirësitë për arritjen e një marrëveshjeje të re mes Fuqive të Adriatikut⁴⁸. Nga ana tjetër, Fuqitë e tjera të Mëdha ishin të bindura për të mos i lënë fushë të lirë veprimi zbatimit të paritetit austro-hungaro-italian në Shqipëri. Në një situatë të tillë, çështja e specialistëve dhe këshilltarëve të huaj në ndihmë të qeverisë shqiptare ngërtheu në vetvete mosbesimin dhe rivalitetin e kamufluar mes dy aleatëve të Tripalëshit, shoqëruar me rivalitetin e hapur dhe të skajshëm për dominim të gjashtë të Mëdhenjve.

Politika koncensionare e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, pariteti austro-hungaro-italian dhe Banka Kombëtare Shqiptare

Politika ekonomike e ndjekur nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës u kushtëzua nga pariteti austro-hungaro-italian edhe në lidhje me koncensionet. Krahas qëllimit në funksion të rimëkëmbjes së financave të dobëta të shtetit të porsalindur shqiptar, politika koncensionare u zbatua dhe për të siguruar mbështetjen e Fuqive të Mëdha, ku spikasin ato të Adriatikut. Ismail Qemal Vlora ndante mendimin që “*projektet e mëdha të dy shteteve protektorë*” duhej të ndaheshin midis tyre në bazë të parimit të paritetit. Në lidhje me ndërmarrjet më të vogla, siç konsideroheshin ndërtimi i tramvajeve, i hoteleve, i godinave qeveritare, impianteve të rrjetit të ndriçimit etj., vendimi duhej t’u lihej në dorë autoriteteve vendase dhe grupeve lokale të interesit⁴⁹. Parashikohej që me koncesion të shtrihej kabloja telegrafike midis Shëngjinit dhe Barit, të bëhej ndërtimi i hekurudhës Vlorë-Durrës-Shkodër, ndërtimi i tramit dhe portit në Vlorë⁵⁰.

Koncesioni më i rëndësishëm dhe i përmasave të mëdha që Qeveria e Përkohshme e Vlorës i akordoi Fuqive të Adriatikut ishte ai i

1914; *po aty*, Vj. 24-33-3348. Relacion i përgatitur për ministrin e Punëve të Jashtme nga specialisti, Jovanoviç, Vjenë, 10 prill 1914.

⁴⁸ *Po aty*, Vj. 24-33-3325. Relacion i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për ambasadorin në Romë, Vjenë, 27 prill 1914.

⁴⁹ *Po aty*, Vj. 23-15-1586. Relacion i konsullit austro-hungarez në Vlorë për ministrin e Punëve të Jashtme, kontin Berchtold, Vlorë, 13 gusht 1913.

⁵⁰ K. Naska, “Politika ekonomike e Qeverisë së Vlorës...”, f. 88-89; Arben Puto, *Shqipëria Politike, 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 42; “Trami në Vlorë”, *Përlindja e Shqipëniës*, Vlorë: 27 gusht 1913.

Bankës Kombëtare Shqiptare. Në lidhje me krijimin e institucionit qendror financiar, në rrethet politike dhe ekonomike shqiptare u shfaq edhe mendimi për krijimin e bankës kombëtare me kapitale shqiptare, të cilat mendohej se ekzistonin në vend dhe në diasporë. “*Po të donte qeveria - shprehej gazeta Shqypnia e Re - që të formonte një bankë serioze dhe të vlefshme, atëherë le të ftonte kapitalistët tanë në një kongres financiar dhe kështu banka mund të themelohej për fitim të kombit dhe me pëlqimin të të gjithë shqiptarëve*”⁵¹. Vështirë të mendohej se në atë kohë, por edhe më vonë, Shqipëria të kishte mundësi reale për të themeluar e vetme një bankë kombëtare. Për të gjitha sa më sipër, Qeveria e Përkohshme e Vlorës nën ndikimin e fortë të politikës së Austro-Hungarisë dhe të Italisë, i dha udhë krijimit të bankës kombëtare me kapitale të huaja, respektivisht gjysmë austro-hungareze dhe gjysmë italiane. Madje, profesori italian Alessandro Rosselli evidenton presionin e ushtruar prej tyre ndaj qeverisë shqiptare për themelimin e bankës, si kusht për fillimin e punimeve të Komisionit Ndërkombëtar të Kufirit Jugor⁵².

Themelimi i Bankës Kombëtare, ashtu sikurse ishte parashikuar në negociatat aktive mes dy Fuqive të Adriatikut, u realizua para se Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit të mbërrinte në Vlorë. Ai mbështetej në marrëveshjen koncesionare të datës 4 tetor 1913, midis Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe përfaqësuesve të Wiener Bank Verein dhe të Banca Commerciale d’Italia. Koncesioni jepej në përputhje me vendimin e Qeverisë së Përkohshme, të datës 2 tetor 1913 dhe kohëzgjatja e tij ishte 60-vjeçare. Kontrata mori vlerë të plotë ligjore pas ratifikimit nga grupi bankar austro-italian dhe publikimit të koncesionit, më 3 dhjetor 1913 në gazetën “Përlindja e Shqypnies”, organ zyrtar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës⁵³.

Sipas marrëveshjes, kapitali i bankës do të ishte 10.000.000 korona, i konvertuar në 10.500.000 lira dhe duhet të paguhej vetëm ashtu siç do të kërkohej prej bankës. Ky kapital do të ishte në monedha ari dhe mund të shtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve (neni

⁵¹ *Shqypnia e Re*, Shkodër: 16 tetor 1913, f. 2.

⁵² Alessandro Roselli, *Italy and Albania: Financial Relations in the Fascist period*, London-New York: I.B.Tauris@Co.Ltd, 2006, f. 8-9; shih edhe: Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, f. 155.

⁵³ *Përlindja e Shqipënisë*, Vit’i I, nr. 27, Vlorë, 20/3 dhjetor 1913, f. 3. Banka Kombëtare Shqiptare. Akt Koncesie.

2). Selia qendrore e bankës do të vendosej në kryeqytetin e Shqipërisë dhe, në përputhje me nevojat mund të hapeshin degë dhe filiale si brenda, ashtu edhe jashtë vendit (neni 3). Sipas nenit 4, institucioni më i lartë drejtues i Bankës Kombëtare Shqiptare ishte Këshilli Administrativ, i përbërë nga një numër i barabartë përfaqësuesish të dy grupeve financiare dhe prej “elementësh shqiptarë”. Por, vlera e këtij neni karshi “elementëve shqiptarë” kufizohej dukshëm nga klauzolat e paragrafëve 2 dhe 4 të tij. Aty përcaktohej se këshilli i parë administrativ krijohej vetëm nga dy grupet themeluese austro-italiane, ndërsa emërimet dhe rinovimet e administratorëve shqiptarë do të bëheshin nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, sipas një liste të vendosur në marrëveshje midis qeverisë shqiptare dhe këshillit administrativ të bankës. Qeveria shqiptare nuk vendoste dot në listë kandidaturat e saj, pa rënë më parë në marrëveshje me përfaqësuesit austro-italianë të dy grupeve financiare.

Këshilli Administrativ kishte nën varësi një komitet, i cili përbëhej nga dy ose katër anëtarë prej grupit financiar austro-hungarez dhe atij italian. Pjesë e tij nuk ishte asnjë përfaqësues shqiptar. Administrimi dhe veprimtaria e bankës kryheshin sipas ligjeve të shtetit shqiptar (neni 5). Vetëm pas një marrëveshjeje paraprake me Këshillin Administrativ, qeveria shqiptare kishte të drejtë të emëronte një komisar të lartë, i cili do të kontrollonte lëshimin e kartëmonedhave bankare dhe do të vëzhgonte me rreptësi zbatimin e dispozitave të statuteve dhe rregulloreve që i referoheshin procedurave të lëshimit të tyre. Por, komisari i lartë nuk kishte të drejtë të përzihej në administrimin dhe drejtimin e punëve të bankës (neni 6).

Banka emetonte monedha, kujdesej për qarkullimin e tyre, blinte metale me vlerë dhe ishte i vetmi agjent financiar i qeverisë, si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë (neni 7). Pavarësisht ndërhyrjes së kryetarit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës për të forcuar elementin shqiptar brenda bankës, neni 11 përcaktonte që grupi austro-italian kishte “të drejtën e preferencës për të gjitha koncesionet që do të japë shteti, si edhe për të gjitha punët e ndërtimeve dhe të gjitha furnizimet për rezervat e shtetit”⁵⁴. Në këtë mënyrë, ai kishte një monopol faktik në të gjitha ndërmarrjet financiare dhe industriale në Shqipëri. Ismail Qemal Vlora ndërhyri edhe në përmbajtjen e nenit 21, duke ia dalë të siguronte të drejtën e kontestimit. Sipas shtesës bërë prej tij, në rast kontestimi mbi

⁵⁴ *Po aty.*

klauzolat e koncesionit ose të procedurave gjyqësore, që mund të shfaqeshin midis qeverisë shqiptare dhe bankës, lidhur me zbatimin e statuteve ose për arsye të punës sociale, marrëveshja i nënshtrohej Gjykatës Federale të Lozanës, pa mundësi apelimi a rekursi⁵⁵.

Banka Kombëtare nuk zhvilloi ndonjë veprimtari të mirëfilltë financiare. I vetmi veprim i saj u krye në datën 6 tetor 1913, pra vetëm dy ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes koncesionare. Bëhet fjalë për një depozitë prej 545.283 groshësh (rreth 4.000 sterlina) të bërë nga ana e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës pranë “Sindikatës së Bankës Kombëtare të Shqipërisë-Zyra e Thesarit”. Nga shuma e përgjithshme, 257.000 grosh u tërhoqën nga banka me tre këste, pjesa tjetër prej 288.000 groshësh, mbeti e depozituar në degën e Thesarit. Sipas Haxhi Shkozës, inspektor financiar në Oborrin e Mbretit Zog I, kjo shumë rezultoi të ketë qenë e pandryshueshme deri në qershorin e vitit 1914⁵⁶. Më tej, dokumentacioni mungon, çka e bën të pamundur prognozën mbi fatin e shumës së depozituar.

Debatet për Bankën Kombëtare Shqiptare në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit dhe kancelaritë ndërkombëtare

Krijimi i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, si një nga kompromiset midis Fuqive të Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve nuk i sheshoi mosmarrëveshjet e vjetra midis tyre mbi kompetencat dhe karakterin e tij. Përkundrazi, mosmarrëveshjet dhe përplasjet e reja u shfaqën që në momentin kur ai duhej të fillonte funksionim e më tej⁵⁷. Austro-Hungaria më shumë, por edhe Italia, të cilat nuk kishin qenë iniciatore dhe mbështetëse pa kushte të krijimit të organizmit ndërkombëtar, synuan drejtimin dhe dominimin e veprimtarisë së tij. Qëllimi final kishte të bënte me zhvleftësimin e misionit të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, si një ndërmarrje e gjashtë Fuqive të Mëdha, në funksion të triumfit të politikës së tyre paritare për dominimin e rajonit adriatiko-ballkanik, si zonë ekskluzive e sferës së tyre të influencës.

⁵⁵ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët...*, Vëll. I, përg. V. Duka, f. 414-423. Koncesioni i datës 4 tetor, në të cilin janë evidentuar shtesat dhe ndryshimet e kryetarit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës.

⁵⁶ Haxhi Shkoza, *Financat e Shqipërisë (1839-1934)*, Tiranë: Nikaj, 1935, f. 779-780.

⁵⁷ P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë...*, f. 138.

Një nga çështjet ku u pasqyrua qartë zhvendosja e debatit kontravers nga tryezat diplomatike të Konferencës së Londrës në ato të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit në Vlorë, është ajo e Bankës Kombëtare Shqiptare. Trajtimi i kësaj çështjeje nisi në mbledhjen e datës 27 nëntor 1913. Diplomati i lartë britanik, Lamb në raportin e përgatitur për Foreign Office në fillim të nëntorit 1913 parashtron një fakt tejet interesant, që thekson ndryshimin e qëndrimit të kryetarit të Qeverisë së Përkohshme karshi politikës paritare të Fuqive të Adriatikut. “*Si provë e sinqeritetit të tij ndaj Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit*”, shprehet Lamb, Ismail Qemal Vlora “*i dha kolegut tim francez kopje të projekteve origjinale dhe përfundimtare të kontratës së nënshkruar me koncesionarët e Bankës Kombëtare*”, shoqëruar me premtimin për të mbajtur të informuar KNK-në për çdo negociatë të ngjashme që mund të zhvillohej⁵⁸.

Debati fillimisht u përqendrua në vlefshmërinë e aktit koncesionar dhe më pas vlerësimin e kontratës për krijimin e bankës⁵⁹. Në diskutimet e tyre, anëtarët francez, rus e britanik të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit mbrojtën pikëpamjen se Qeveria e Përkohshme e Vlorës kishte shkelur vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, sipas të cilit, Shqipëria duhej të qeverisej në mënyrë unike nga të gjashtë Fuqitë e Mëdha. Ajo nuk kishte të drejtë të jepte koncesione përfundimtare për një periudhë të gjatë kohore që angazhonin të ardhmen ekonomike të të gjithë Shqipërisë, nën arsyetimin se autoriteti i saj qeverisës nuk e mbulonte të gjithë njësini territoriale të shtetit shqiptar. Kjo e drejtë i përkiste Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, i cili ishte i vetmi organ i rregullt administrativ, që pasi analizonte avantazhet e koncesionit, mund

⁵⁸ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët...*, Vëll. I, përg. V. Duka, f. f. 353, Konsulli i përgjithshëm Lamb për E. Grey-n, Vlorë, 5 nëntor 1913.

⁵⁹ A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit...*, f. 467-470. Seanca e 23-të e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, Vlorë, 23 nëntor 1913; *po aty*, f. 478-480. Seanca e 30-të e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, Vlorë, 8 dhjetor 1913; *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët...*, Vëll. I, përg. V. Duka, f. 471-473; Konsulli i përgjithshëm Lamb për sekretarin britanik të Punëve të Jashtme E. Grey-n, Vlorë, 27 nëntor 1913; *po aty*, f. 495. Sekretari britanik i Punëve të Jashtme E. Grey për konsullin e përgjithshëm Lamb, Londër, 10 dhjetor 1913; *po aty*, f. 523. Konsulli i përgjithshëm Lamb për sekretarin britanik të Punëve të Jashtme, E. Grey, Vlorë, më 8 dhjetor 1913; *po aty*, f. 539-541. Konsulli i përgjithshëm Lamb për sekretarin britanik të Punëve të Jashtme, E. Grey, Vlorë, 11 dhjetor 1913.

ta akordonte ose jo atë. Mbi këtë kriter, koncesioni i Bankës Kombëtare u vlerësua nga përfaqësuesit e Antantës, si i njëanshëm dhe tepër i shtrenjtë për financat e dobëta shqiptare⁶⁰. I këtij mendimi, ndonëse nuk e artikulonte hapur në rrugë diplomatike, ishte edhe Gjermania. Sekretari gjerman i Shtetit për Punët e Jashtme në letrën private dërguar ambasadorit në Vjenë, shprehej se *“Banka Shqiptare, ndonëse në një formë pak të fshehur, nuk ka tjetër kuptim veçse atë të një monopoli italo-austriak dhe në këtë mënyrë kundërshton parimin për të cilin neve jemi përpjekur kudo, d.m.th parimin e derës së hapur”*⁶¹.

Çështja e krijimit të Bankës Kombëtare Shqiptare, krahas Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, u trajtua edhe në kancelaritë ndërkombëtare përkatëse. Fuqitë e Mëdha, përveç Austro-Hungarisë dhe Italisë, ndonëse njihnin krijimin e institucionit, kërkonin ndërkombëtarizimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, e cila duhej të ishte një investim i përbashkët dhe i barabartë i të gjitha Fuqive të Mëdha dhe jo vetëm i dy prej tyre⁶². Në rrethanat e shfaqjes së tërheqjes italiane, politika e së cilës lëkundej mes besnikërisë ndaj Tripalëshit dhe flirtimit me Antantën, në rrethet diplomatike doli në pah këmbëngulja e skajshme e Perandorisë Dualiste. Ajo nisi të uli kokën vetëm në shkurt të 1914-ës, kohë kur Austro-Hungaria pranoi ndërkombëtarizimin e përkohshëm të bankës, me *“kushtin që në Bankën e Shtetit të sigurohet një pozicion i veçantë për Austro-Hungarinë dhe Italinë, për shkak të interesave të tyre shumë më të mëdha në Shqipëri, të krijuara nga pozicioni i tyre gjeografik”*⁶³. Pozicioni i veçantë i dy Fuqive të Adriatikut kishte të bënte me zotërimin e 60 % të kapitalit të bankës, ndërsa 40 % i mbetur do të

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ *AIH*, A-VI-13, “Politika e kabineteve europiane prej shtator 1913 gjer në korrik 1914”, fl. 1419. Letër private e sekretarit gjerman të Shtetit për Punët e Jashtme për ambasadorin në Vjenë, 25 janar 1914.

⁶² *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët...*, Vëll. II, përg. V. Duka, f. 103. Ambasadori britanik në Gjermani, E. Goschen për sekretarin e Punëve të Jashtme, E. Grey, Berlin, 16 janar 1914; *po aty*, f. 147-148. Ambasadori britanik në Romë, R. Rodd për sekretarin e Punëve të Jashtme, E. Grey, Romë, 31 janar 1914; *po aty*, f. 171-172. Sekretari britanik i Punëve të Jashtme, E. Grey për ambasadorin në Vjenë, M.de.Bunsen, Londër, 10 shkurt 1914; *po aty*, f. 222-225, Sekretari britanik i Punëve të Jashtme, E. Grey për ambasadorin në Shën Petersburg, G. Buchanan, Londër, 4 mars 1914; *po aty*, f. 227. Sekretari britanik i Punëve të Jashtme, E. Grey për ambasadorin në Shën Petersburg, G. Buchanan, Londër, 6 mars 1914.

⁶³ *Po aty*, f. 172. Notë e qeverisë austro-hungareze për homologen e saj franceze, shkurt 1914.

duhej të ndahej në mënyrë të barabartë mes katër Fuqive të tjera të Mëdha. Tërheqja, ndonëse jo tërësore, ndodhi në kushtet e presionit francez dhe rus, të cilët kushtëzuan dhënien e huasë për Princin Wilhelm Wied me çështjen e Bankës Kombëtare Shqiptare. Në mënyrë të përsëritur, që prej dhjetorit 1913, ata kishin deklaruar se do të merrnin pjesë në garantimin e huasë shqiptare, vetëm nëse “*Banka Kombëtare do të ndërkombëtarizohej dhe Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit do të merrte në dorë organizimin administrativ e financiar të Shqipërisë dhe do të ushtronte kontrollin e huasë*”⁶⁴. Në këtë mënyrë, garantimi i huasë nga të gjashtë Fuqitë e Mëdha u lidh ngushtësisht me çështjen e ndërkombëtarizimit të Bankës Kombëtare Shqiptare, rregullimi i të cilave, me të drejtë konsiderohej nga qeveria britanike si një nga mjetet më të përshtatshme për të forcuar pozitën e Princit dhe për të bërë të mundur një administrim të efektshëm të shtetit shqiptar⁶⁵.

Në kushtet e mosarritjes së konsensusit për përqindje të barabartë mes Fuqive të Mëdha në aspektin e investimit financiar të bankës, diskutimet u përqendruan në arritjen e dakortësisë për ekipin drejtues dhe administrues të bankës. Fuqitë e Adriatikut u tërhoqën dhe tashmë nuk bëhej fjalë më vetëm për pjesëmarrje paritare austro-hungareze dhe italiane, sikurse parashikohej në marrëveshjen koncesionare të tetorit 1913, por për një shpërndarje postesh mes të gjitha Fuqive të Mëdha. Një post që u diskutua gjatë ishte ai i guvernatorit të bankës. Fuqitë e Antantës në unison kërkuan që guvernatori të ishte britanik, ndërkohë që Austro-Hungaria nguli këmbë që ai të ishte austriak ose hungarez. Debatet e zgjatura vijuan deri në korrik 1914, pa arritur një kompromis tërësor mbi çështje të ndryshme që kishin të bënin me Bankën Kombëtare Shqiptare. Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore e la atë peng të rivalitetit mes Fuqive të Mëdha.

Përfundime

Marrëdhënia mes Fuqive të Adriatikut dhe shtetit shqiptar në vitet 1912-1914, u përvijua ngjashmërisht sikurse ajo e *Qendrës me Periferinë*

⁶⁴ *AIH, A-VI-13*, “Politika e kabineteve evropiane prej shtatorit 1913 ...”, fl. 1170-1173. Zëvendësdelegati gjerman në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, Nadolny për kancelarin e Rajhut, Vlorë, 15 dhjetor 1913.

⁶⁵ *Po aty*, fl. 1490-1491. Ambasadori gjerman në Londër për kancelarin e Rajhut, Londër, 29 maj 1914.

në Teorinë Strukturore të Imperializmit të Johan Galtung. Në themel të kësaj marrëdhënieje ishte *koncepti i interesit*, i cili sa i përket dy fuqive që luajnë rolin e Qendrës, formësohet mbi *vlerën e barazisë* mes tyre. Ndërsa në raportin që Qendra përvijon me Periferinë, pra me shtetin shqiptar dhe Qeverinë e Përkohshme të Vlorës koncepti i interesit nuk rezulton të ndjekë të njëjtën premisë barazie. Si më e dobëta në këtë marrëdhënie, Qeveria e Përkohshme e Vlorës, me status të panjohur nga Fuqitë e Mëdha, në një periudhë tranzitore pushteti, u gjend në një marrëdhënie të pabarabartë, e detyruar të pranojë varësinë dhe nënshtrimin nga Fuqitë e Adriatikut.

Dominimi ekonomik në Shqipëri u përdor nga Austro-Hungaria dhe Italia si mjet përmes të cilit do të sigurohej edhe mbizotërimi politik, duke synuar mënjanimin sa më shumë të ishte e mundur të Fuqive të tjera të Mëdha në çështje që kishin të bënin me shtetin e pavarur shqiptar. Në këtë drejtim, pengesa që mban emrin “Antantë”, rezultoi të ishte e pakapërxyeshme. Franca, Rusia dhe Britania e Madhe, duke u mbështetur në *parimin e ndërkombëtarizimit* mbi baza paritare nga të gjashtë Fuqitë e Mëdha, nuk lejuan dominimin ekonomik dhe politik të shtetit të pavarur shqiptar vetëm nga Austro-Hungaria dhe Italia. Në një situatë të tillë, si çështja e specialistëve dhe këshilltarëve të huaj, ashtu sikurse edhe ajo e Bankës Kombëtare Shqiptare mbetën peng të rivalitetit të Fuqive të Mëdha dhe nuk morën zgjidhje përfundimtare.

S u m m a r y

THE IMPLEMENTATION OF THE HABSBURG-ITALIAN ECONOMIC PARITY IN ALBANIA (1912-1914)

The relation between the Adriatic Powers and Albania in the period from 1912 to 1914 fit in the *center-periphery relation* theory that Johan Galtung has elaborated in his Structural Theory of Imperialism. The basis of this relation was the *concept of interest* which had put both Powers acting as the Center on *an equal footing*. While in the relation established between the Center and the Periphery, the latter represented by the Albanian state and the Provisory Government of Vlorë, the concept of interest was not founded on the same

equality pattern. As the weaker party in this relation, the Provisory Government of Vlora which was not recognized by the Great Powers and held transitory office, was inferior and obliged to accept dependency and subjugation by the Adriatic Powers.

The economic control of Albania was used by both Austro-Hungary and Italy as a means to secure political domination in the country, aiming at excluding as much as possible the involvement of other Great Powers in matters concerning the independent Albanian state. However, the Entente Powers were an obstacle which resulted to be impregnable. France, Russia and Great Britain did not allow the exclusive economic and political domination of the independent Albanian state by Austro-Hungary and Italy. Therefore, the question of assigning foreign specialists and advisers for Albania along with the question of the Albanian National Bank did not receive a definitive solution due to the rivalry among the Great Powers.